

# KUTIA E ANKESAVE



Kush do ta hap kutinë?

Kutinë do ta hap një komision i pavarur i përbërë nga dy mësimdhënës, dy nxënës dhe një ose dy prindër, si dhe pedagogu apo psikologu i shkollës.

Detyrat e komisionit!

Ky komision ka për detyrë që t'i paraqes raport më shkrim drejtorit të shkollës dhe këshillit drejtues lidhur më të dalurat nga kutia, ku do të kërkojë nga drejtori i shkollës dhe këshilli drejtues që të ndërmerren masa konform ligjeve në fuqi nëse ankesat janë të bazuara në fakte.

Kutia e ankesave është mekanizëm i besueshëm ku ju mund të na njoftoni për parregullsitë dhe shkeljen e të drejtave të fëmijëve që bëhen brenda shkollës.

Mos ke frikë të na shkruash,  
kutia është vetëm për ju!!




Syri i Vizionit



Save the Children

# KUTIA E ANKESAVE





Nuk është e domosdoshme që të shkruani emrin dhe mbiemrin tuaj në letrën që adresoni përmes kutisë, është shumë me rëndësi që ajo çfarë shkruhet nga ju të jetë e bazuar në fakte, dhe jo diçka e imagjinuar apo me ndonjë qëllim të caktuar. Asnjëherë nuk do të zbulohet identiteti i juaj, qoftë ankesë, kërkesë, lëvdatë apo diçka tjetër që është në interes të fëmijëve dhe shkollës. Është e ndaluar që në Kutinë e Ankesave të futën shkrime dhe vizatime me përmbajtje banale apo ofenduese e që bie në kundërshtim me rregullat dhe disiplinën shkollore dhe që nuk përkrijnë më etikën edukative dhe arsimore të shkollës.

Kutia e ankesave

është një mekanizëm brenda shkollës suaj, ku ju do të mund t' i adresoni përmes formës së shkruar:

- \* Shkeljen e të drejtave të fëmijëve
- \* Shqetësimet gjatë procesit mësimor
- \* Denoncimi rastet e dhunës dhe diskriminimit
- \* Lëvdatat dhe sugjerimet për mësimdhënësit dhe stafin tjetër të shkollës
- \* Idetë dhe propozimet për shkollën

### Kur do të hapet kutia?

Kutia, do të hapet çdo muaj, ku do të trajtohen të gjitha letrat që janë adresuar në të nga ana juaj. Përmes një njoftimi me shkrim do të njoftoheni se kur është hapur kutia dhe do të përpilohet një raport me përmbajtjen e saj.

↑  
**KUTIA E  
ANKESAVE**